

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Duke u bazuar në nenin 108/A paragrafi 14 sipas nënparagrafit 2 të paragrafit 10, nenin 109 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, nenin 3.3 dhe 8.3 për Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.26 lidhur me nenin 109 paragrafi 1 të LPP-së, brenda afatit ligjor pas nxjerrjes së Vendimit Nr.prot..... të dt.22/05/2019 të lëshuar nga autoriteti kontraktues - Ministria e Infrastrukturës në procedurën paraprake kundrejt Kërkesës për Rishqyrtim të ushtruar në konzorciumit të përbërë nga OE "El-Bau Sh.p.k.&Conex Group Sh.p.k.", sot me dt. 01.06.2019 e parashtrorjme këtë:

ANKESË

Kundër:

1. Vendimit të AK-së të dt. 22/05/2019, me të cilin është Refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e grupit të OE "El-Bau&Conex Group" e dt. 21.05.2019 dhe është lënë në fuqi vendimi i atakuar;
2. Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, grupin e OE "El-Bau Sh.p.k.&Conex Group Sh.p.k.", i dt. 14.05.2019;
3. Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban" për Lot 2, i dt. 14.05.2019;

Një ankesë kundër: **MINISTRISË TË INFRASTRUKTURËS**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Nr. i prokurimit: 205-19-1262-2-1-1**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Nr i brendshëm: MI-19-014-211

Sa i përket tenderit me titull: **"Mirëmbajta rutinore dhe dimërore të autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) e A6 deri në kyqjen në konjuh si dhe rrugën Nacionale N9 - Lot 2 "**

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i OE: **"EL-BAU" sh.p.k. & CONEX GROUP" sh.p.k."**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gjilan, Rr. Nato 99

(Adresa)

Gjilan, Kosovë

60000

(Vendi)

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it) **044244330**

01.06.2019

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës e parashitro ankesën vvetëm

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- 21 mars 2019 - Data e dorëzimit të Njoftimit për Kontratë në KRPP sa i përket tenderit me titull: Mirëmbajta rutinore dhe dimërore të autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) e A6 deri në kyqjen në konjuh si dhe rrugën Nacionale N9".me nr. prokurimi MI-19-014-211
- Në këtë rast kemi të bëjmë me procedurë të hapur ku kriter për dhënien e tenderit është Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Objekti i tenderit ka qenë i ndarë në 2 pjesë (lot);
- 15 prill 2019 - sipas Njoftimit për Kontratë, i shtyrë për dt. 19 prill 2019 sipas shkresës së dt 12 prill- Afati i fundit për Dorëzimin e Tenderëve;
- 14 maj 2019 - Kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar;
- 14 maj 2019 - Publikohet në KRPP Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues sipas të cilit dhënia e kontratës për Lot 2 iu është dhënë OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban“ me çmim të ofertuar prej 3,500,654.70€ e cila është më e shtrejtë se oferta e grupit të OE "El-Bau&Conex Group" prej 250,712.70€;
- 20 maj 2019 - OE "El-Bau" Sh.p.k. në emër të konzorciumit ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoritetit Kontraktues MI, kundër: Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, grupin e OE "El-Bau Sh.p.k.&Conex Group Sh.p.k." dhe vendimin të AK-së për dhënien e kontratës për Lot 2 OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban“;
- 22 maj 2019- Autoritetit Kontraktues, Ministria e Infrastrukturës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka nxjerrë Vendimin Nr. prot 5482 të dt.22/05/2019 me të cilin është Refuzuar si e pabazë Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar në emër të grupit të konzorciumit nga OE ankues "El-Bau Sh.p.k" duke vërtetuar dhe lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban“ për Lot 2 , i dt. 14.05.2019;
- 01 qershor 2019 - Paraqitet kjo Ankesë në OSHP nga OE "El-Bau"

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Nuk ka vërejtje sa i përket procesit të hapjes së Tenderëve

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☒

AK- MI, përmes Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar 0E "El-Bau&Conex Group", në arsyetimin e dhënë ka konstatuar se nuk i plotësojmë kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit, me arsyetimin e dhënë si në vijim:

- a) Në dosjen e tenderit tek specifikat e teknike janë kërkuar dhjetë (10) shpërndarësit automatik të kripës, ndërsa operatori ekonomika ofruar dëshmi/dokument mbi pronësinë për 6 Shpërndarësit automatik të kripës;
- b) janë kërkuar 10 automjete transportuese (kamion) në të cilin montohen borëheqëset (pflugjet) dhe shpërndarësit automatik të kripës të cilat duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa kompania ka ofruar një kamion me nr. 06-397 DL pa afat të regjistrimit

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- 1) Neni 1 - Qëllimi, për arsye se nuk është arritur Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë për shkak se nuk është marrë në konsideratë qëllimi, lënda e prokurimit për tu duke siguruar që do të mere vlerën për paranë (Best value for many).

- 2) **Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti** - për arsye se nuk është udhëhequr në pajtim me parimin e ekonomikitetit&efikasitetit që të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parandë për AK për shkak se ka përzgjedh ofertën e tenderuesit të papërgjegjshëm e cila është rreth 250,712.70€ më të shtrenjtë se oferta e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë e OE Ankues "El-Bau-Conex Group"
- 3) **Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, 7.1.** Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente; 7.2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.
- 4) **Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi** - për arsye se me qëllim të favorizimit të OE fitues të rekomanduar për dhënien e kontratës me çmim më të shtrejtë për 250,712.70€, e eliminon OE ankues, sa i përket arsyetimit në pikën a) mbi bazën e vërtetimit të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike dhe duke mos zbatuar drejt dhe ligjshëm në tërësi dispozitën e nenit 59.4 të LPP-së, e në anën tjetër sa i përket i përket arsyetimit të dhënë në pikën b) mbi bazën vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, duke mos zbatuar në plotni nenin 59.4 pika iii) që rregullon e përcakton devijimet e vogla që nuk shkaktojnë ndryshime materiale, nenit 69 par.4.5 të LPP-së dhe mbi bazën e zbatimit të gabueshëm të drejtës materiale që nuk përcaktohet në bazë të legjislacionit të prokurimit publik.
- 5) **Neni 56 - Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave - neni 26 i RrUOPP (Kriteret e përzgjedhjes)** - për arsye se dyshojmë se OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar kërkesat e kualifikimit (përzgjedhjes) të specifikuara në njoftim të kontratës dhe në dosjen e tenderit. I njejtë ka aplikuar në të dy lotet, ne ngrisim pretendimin se nuk i ka plotësuar kërkesat të kapacitetit teknik të nenit 9.1&9.2 pika 5 të FTD-së së DT-së (nuk i ka ofruar pajisjet për të dy pjesët sipas listës tek Aneksi 1).
- 6) **Neni 59 par. 2 dhe 4 i LPP-së dhe neni 41.3 i RrUOPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** - për arsye se vlerësimi është udhëhequr në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parimin e ligjshmërisë (legjislacionit të aplikueshëm material për prokurimin publik - LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim), parimin e efikasitetit/efektivitetit (parimit të ruajtjes së vlerës për para) që ka rezultuar me një vendimarrje e padrejtë e të paligjshme mbi bazën e vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike dhe aplikimit të ligjit jomaterial/joprocedural për një çështje (skadimin e regjistrimit të një kamioni) që kjo sipas kuptimit të pikës iii) të paragrafit 4 të nenit 59 mund të konsiderohet devijim i vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndryshuar kushtin material. Në anën tjetër për AK nuk ka paraqitur problem që rekomandojë për dhënie të kontratës një OE që nuk plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies së

kontratës e cila është rreth 250,712.70€ më të shtrenjtë se oferta e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë e OE Ankues "El-Bau-Conex Group".

- 7) **Neni 60 – Kriteret për dhënien e kontratës** – për arsye se grupi i OE ankues përkundër iu është mohuar dhënia e kontratës si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët karrshi OE të rekomanduar për kontratë (250,712.70€ më e lirë se oferta e fituesit) në bazë të gjendjes faktike dhe nga një rivlerësim i drejtë dhe i ligjshëm rezulton se ankuesi ka dorëzuar tender të përgjegjshëm në përputhshmëri me kërkesat formale të nga aspekti administrativ dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e kualifikimit (kriteret e përzgjedhjes) të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit si dhe tenderin që plotëson kriterin e dhënies së kontratës. Në anën tjetër konsiderojmë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesat e minimale të kualifikimit që hyn tek kërkesat e përzgjedhjes të cilat nga AK janë specifikuar në njoftimin për kontratë dhe dosjes së tenderit në kuptim të nenit 56 paragrafi 1.1. të LPP-së, andaj i njëjti nuk është dashur mos të kalojë fare në vlerësimin e kriterit për dhënien e kontratës sipas kriterëve të vendosura në nenin 60 paragrafi 1.1. të LPP-së, që është kusht i detyrueshëm ligjor.
- 8) **Neni 64 pika iii) i LPP-së– Dëshmitë e Kërkesave** – për shkak se AK me rastin e vensosjes së kërkesës në pikën 5 të nenit 9.2 lidhur me nenin 9.1 të FTD-së lidhur me kërkesën për regjistrimin e mjeteve nuk ka vepruar në harmoni me nenin 64 pika iii) të LPP-se
- 9) **Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale** – për arsye se kundrejt grupit të grupit të OE ankues "El-Bau&Conex Group", AK në arsyetimin e dhënë për eliminim sa i përket kërkesës në pikën 5 nenin 9.1&9.2 të FTD-së duke shkelur nenin 69 par.4.5 ka nxjerrë vlerësim të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike mbi bazën e aplikimit të gabueshëm të kësaj dispozite materiale dhe zbatimit të ligjeve tjera jomateriale.
- 10) **Neni 72 i LPP-së dhe neni 39 dhe 41.7 i RrUOPP– Dokumentacioni dhe informacioni shtesë** – për arsye se AK kundrejt grupit të grupit të OE ankues "El-Bau&Conex Group", fare nuk e ka zbatuar këtë dispozitë të së drejtës materiale që në rastin konkret ka pasur detyrim ta zbatojë për të kërkuar nga OE ankues informacione shtesë për të sqaruar këtë aspekt të tenderit lidhur me çështjen që e ka përdorur për eliminim me arsyetimin e dhënë në pikën a) të Letrës Standarde edhe pse kjo çështje është tejte e qartë si në aspektin faktik e po ashtu edhe në kontekst ligjor ngase të gjitha dëshmitë dokumentare për ta plotësuar kërkesën nga neni 9.1&9.2 pika 5 janë pjesë e dosjes së tenderit siç edhe do të vërtetohet nga përshkrimi që do ta bëjmë mbi bazën e këtyre dëshmimeve dokumentare. E ndërsa në anën tjetër kundrejt OE të rekomanduar me kontratë për të njëjtën çështje me gjendje të njëjtë ekzistuese dokumentet (librezat) me përshkrim të njëjtë për AK-në kanë qenë të pranueshme konform kërkesës në fjalë. Pra këto AK ka përdorur standarde të dyfishta, për OE të

rekomanduar për dhënie të kontratës ky dokument ka qenë i pranueshëm ndërsa për OE ankues ka qenë i papranueshëm

11) Neni 108/A paragrafi 12 - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve i LPP-së - Neni 8.2 i Rregullave për paraqitje të kërkesave për rishqyrtim pranë AK-së

12) **Neni 4.4 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik.** Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim: Konkurrenca - në mesin e furnizuesve duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive; Efikasiteti & Efektiviteti - duhet të dëshmohej në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paratë për AK; Drejtësia/Mos-diskriminimi - Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial; Llogaridhënie - Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme; Profesionalizëm - Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përslikruani rrethuanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të dt. 14.05.2019 kundrejt grupit të OE "El-Bau&Conex Group" siç është konfirmuar edhe në Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të ankuesit, AK pretendon gjoja se grupi i OE ankues nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit, me arsyetimin se:

- a) Në dosjen e tenderit tek specifikat e teknike janë kërkuar dhjetë (10) shpërndarësit automatik të kripës, ndërsa operatori ekonomik ka ofruar dëshmi/dokument mbi pronësinë për 6 Shpërndarësit automatik të kripës;
- b) janë kërkuar 10 automjete transportuese (kamion) në të cilin montohen borëheqëset (pllugjet) dhe shpërndarësit automatik të kripës të cilat duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa kompania ka ofruar një kamion me nr. 06-397 DL pa afat të regjistrimit

Ky arsyetim çoftë në pikpamje të gjendjes faktike e po ashtu në pikpamje ligjore të LPP-së **NUK QËNDRON** për faktin se bazuar në faktet e mbështetura në provat dhe dëshmitë materiale që përbëjnë dosjen e tenderit të dorëzuar nga grupi i OE ankues,

rezulton se të njëjtat gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk janë vlerësuar dhe administruar drejtë dhe ligjshëm për të ardhur deri te një gjendje faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë në pajtim me dispozitën qenësore të nenit 59.4 të LPP-së lidhur me dispozitat përkatëse tjera nenit 1, nenit 6, nenit 7, nenit 69, nenit 72 të LPP-së. Dhe për më tepër shkeljet e lartëcekura nuk janë eliminuar as gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të OE ngase AK ka ngelur në vlerësimin apo rikonfirmimin e rezultatit të njëjtë si pasojë e vlerësimeve jo të drejta dhe jo të ligjshme duke mos marrë parasysh asnjërin nga pretendimet ankimore të kërkesës me shpjegime dhe përshkrime të argumentuara faktike të mbështetura në provat dhe dëshmitë materiale që përbëjnë dosjen e tenderit.

Faktet dhe provat të cilat do t'i pasqyrojmë në mënyrë të argumentuar dhe detajuar në pretendimet ankimore vijuese vërtetojnë se grupi i OE ankues ka plotësuar në tërësi kërkesat e AK-së të parashtruar në nenin 9.2 pika 5 Anexi 1 lidhur me nenin 9.1 të FTD-së, dhe në tërësi duke plotësuar kriteret/kërkesat e përzgjedhjes të dosjes së tenderit dhe kriterin e dhënies si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, mirëpo si pasojë e mos trajtimit të barabartë/diskriminimit në raport me OE fitues dhe shkeljes së qëllimit të LPP-së duke mos siguruar vlera për para në shfrytëzimin e fondeve publike, iu është cenuar e drejta ligjore për tu shpërblyer me kontratë.

Oferta financiare e dorëzuar me dosjen e tenderit nga ana e OE ankues "El-Bau&Conex Group" është 3,249,942.00€, derisa për Kontratë rekomandohet OE "Damastion Project&Via Egnatia", me çmim 3,500,654.70€ e cila është më e shtrejtë se oferta e ankuesit për 250,712.70€. LPP, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik reflektojnë gjithashtu në parimet e prokurimit publik bazë si: vlera për para, ekonomiciteti, efikasiteti, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë, e jo në propozim për dhënie të kontratës ofertës me çmimin më të lartë për 250,172.70 €.

Pretendimi Ankimor Nr.1 - lidhur me arsyen e eliminimit të dhënë në pikën a) të Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar

Sipas këtij arsyetimi, AK konstaton gjoja se tenderi i ankuesit nuk i plotëson kriteret e kërkuara nga AK lidhur me kapacitetin teknik tek specifikat e teknike ku janë kërkuar dhjetë (10) shpërndarësit automatik të kripës, në atë mënyrë që është konstatuar se operatori ekonomik ka ofruar dëshmi/dokument mbi pronësinë për 6 Shpërndarësit automatik të kripës.

Në pikpamje të gjendjes të drejtë faktike ky konstatim **NUK QËNDRON** dhe si i tillë përbën vërtetim të gabuar dhe jo të saktë të gjendjes faktike për faktin se bazuar në provat dhe dëshmitë materiale që përbëjnë dosjen e tenderit të OE ankues në dosje janë të bashkëngjitura dëshmitë materiale/dokumentare për të plotësuar në tërësi siç është kërkuar nga AK kërkesën e kapacitetit teknik të vendosur në pikën 5 - Anexi 1 të nenit 9.1&9.2 të FTD-së. Për të ardhur te kjo gjendje faktike e kundërt me atë çfarë ka pretenduar AK e vërtetojnë faktet dhe provat e pasqyruara në detaje për secilën pajisje vërtetojnë se OE ankues ka paraqitur dëshmi dokumentare sipas kërkesës së vendosur se ka në pronësi/posedim kamion me destinimin special me pajisje pllug për heqjen e borës dhe kripore që vendoset mbi kamion për hedhjen e kripës dhe atë

të mbështetura mbi bazën e dokumenteve egzistenca e të cilave është e fiksuar në dosjen e tenderit. Shih sqarimet e detajuara për secilën pajisje:

- 1) **Kamioni i tipit SCANIA me tabela 06-397-DL pronë e OE "El-Bau - kamioni** dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës dëshmohet me kopjen e librezës e regjistrimit CRA 0989156 ndërsa pajisjet borëheqësi (pllugi) dëshmohet me DUD-in R337 dhe shpërndarësi automatik i kripës dëshmohet me DUD-in R678.
- 2) **Kamioni i tipit VOLVO me tabela 06-120-DP, në pronësi të El-Bau" -** kamioni dëshmohet se ka destinim special pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës dëshmohet me kopjen e librezës e regjistrimit CRA 1038844, ndërsa pajisjet borëheqësi (pllugi) dëshmohet me DUD-in R7714 dhe shpërndarësi automatik i kripës dëshmohet me DUD-in R335.
- 3) **Kamioni i tipit STEYR me tabela 06-679-DF në pronësi të "El-Bau" - kamioni** dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës me librezën e regjistrimit CRA 0935409
- 4) **Kamioni i tipit MAN me tabela 666-KS-209 në pronësi të "El-Bau" - kamioni** dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës
- 5) **Kamioni i tipit MAN me tabela 666-KS-211 në pronësi të "El-Bau" - kamioni** dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës me librezën e regjistrimit CRA 1157385,
- 6) **Kamioni i tipit STEYR me tabela 06-863-CM në pronësi të "El-Bau" -** kamioni dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës me librezën e regjistrimit CRA 0935528
- 7) **Kamioni i tipit STEYR me tabela 06-578-CM në pronësi të "El-Bau" -** kamioni dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës me librezën e regjistrimit CRA 0935505;
- 8) **Kamioni i tipit MERCEDES me tabela 06-273-DJ në pronësi të "El-Bau" -** kamioni dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës me librezën e regjistrimit CRA 0950448
- 9) **Kamioni i tipit UNIMOG me tabela 03-280-GB i huazuar me marrëveshje nga OE Ve-Mor"- kamioni** dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës me librezën e regjistrimit CRA 1065991
- 10) **Kamioni i tipit VOLVO me tabela 03-214-GB i huazuar me marrëveshje nga OE Ve-Mor" - kamioni** dëshmohet se ka destinim special për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës me librezën e regjistrimit CRA 1066035.

Dhe sa për argumentim më të plotë në kuptim të vërtetimit të drejtë dhe saktë të kësaj gjendje faktike se egzistojnë objektivisht, realisht dhe është e vërtetë (fakt i pakontesueshëm) kamionat me mjetet përcjellëse (bashkëngjitëse) siç janë kërkuar në kërkesën e AK-së, OE ankues e VËRTETON EDHE ME FOTOGRAFI për secilin kamion

veç e veç ku shihet dhe identifikohet saktësisht kamioni dhe pajisjet që i kanë të bashkëgjitura/vendosura (pllugin dhe borëpastruesen).

Për më tepër në çdo rast paqartësie, AK ka mundur që në kuptim të aplikimit të nenit 59.2 po 72 të LPP-së me qëllim të sqarimit të plotë të kësaj çështje dhe heqjen e dilemave të kërkojë nga OE ankues informatat apo dokumentacionin e e duhur plotësues (DUD-at, Çertifikata të Atestit, Çertifikatë të Homologimit, etj) egzistenca e të cilave është e fiksuar apo edhe caktojë vizitë në vendpunishtë të OE ankues për të verifikuar një nga një të gjitha pajisjet që janë prezentuar nga ankuesi për këtë aktivitet prokurimi dhe për të cilat ka dilemë.

Në kuptim të sqarimit të tenderit lidhur me çështjen se pse në disa nga librezat e regjistrimit nuk është shënuar vetëm "*kamion për pastrimin e borës*" dhe nuk shënon se kamioni ka të montuara pajisjet speciale shtesë (pllugin dhe borëhedhësen (shpërndarësin automatik të kripës) e sqarojmë se kjo nuk bëhet për shkak se në programin e bazës së të dhënave të regjistrimit të automjeteve të MPB-së nuk është i rregulluar dhe përcaktuar kodi ku mund të përshkruhen këto informacione. Në raste të caktuara ndodh që me insistimin e palës këto të dhëna të shkruhen në rubrikën e fundit të librezës "*shënime*". Me qëllim të qartësimit dhe sigurimit të informacionit shtesë për këtë çështje, AK mund ta verifikojë zyrtarisht përmes organit kompetent MPB-së, e jo të mundohet të përdorë arsye të paqëndrueshme, thelbësisht të pambështetshme në aspektin juridik dhe faktik, dhe mendojmë kjo bëhet si shkak-pasojë të propozohet për dhënie të kontratës oferta me çmimin më të lartë.

Për vëmendjen e juaj slihi se i njëjti përshkrim ndodhet edhe në kopjet e librezave të regjistrimit të OE fitues të rekomanduar për kontratë. Pra për të njëjtën çështje me gjendje të njëjtë ekzistuese AK ka përdorur standarde të dyfishta, për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës ky dokument ka qenë i pranueshëm për AK-në ndërsa për OE ankues ka qenë i papranueshëm. Me këtë fakt ilustron se AK nuk i trajton të gjithë OE në mënyrë të barabartë duke zbatuar parimin e mos-diskriminimit që për rrjedhojë eliminohet konkurrenca e lirë dhe e drejtë, OE fitues favorizohet ndërsa OE ankues diskriminohet.

Pretendimi Ankimor Nr.2 - lidhur me arsyen e eliminimit të dhënë në pikën b) të Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar

AK në arsyetimin e dhënë në pikën b) të Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar – ankuesin ka konstatuar gjoja se kompania ka ofruar një kamion me nr. 06-397 DL pa afat të regjistrimit duke ju referuar kamionit i tipit SCANIA me tabela 06-397-DL pronë e OE "*El-Bau i cili ka destinim special për pastrimin e borës dhe luidhjen e kripës që dëshmohet dëshmitë dokumentare që janë përshkruar në pretendimin e lartshënuar.*

Arsyetimi i AK-së i përdorur për eliminim të OE ankues lidhur me këtë çështje është i bazuar duke mos vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen e saktë faktike, shkelje thelbësore të dispozitës ligjore të nenit 59 par.4 pika iii) që shumë qartë e rregullon dhe lejon situatën kur ka gabime të vogla që nuk e ndryshojnë kushtin material të aspektit të tenderit, zbatimit të gabueshëm të drejtës materiale që tejkalon kufijtë e përcaktuar me

legjislacionin e LPP-së dhe aktet nënligjore lidhur me diskrecionin brenda fushëveprimtarisë dhe kompetencës që ja përcakton ky ligj. Pretendimin e mbështesim mbi bazën e të drejtës ligjore dhe fakteve dhe provave të pasqyruara në pikat si në vijim:

E para: Në nenin 64 (Dëshmitë e kërkesave) pika iii) të LPP-së, përcaktohet *se OE duhet t'i plotësojnë kriteret e kërkuara nga AK sipas nenit 68 - 71*. Pra në kuptim të kësaj dispozite AK ka detyrim ligjor që kriteret e përzgjedhjes në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me kërkesat (ekonomike/financiare, teknike/profesionale) që një OE duhet t'i përmbushë për tu konsideruar i kualifikuar t'i specifikojë sipas dispozitave të neneve 68-71 të LPP-së. Regjistrimi i mjeteve nuk është kategori që aplikohet në bazë të LPP-së. Ligji i Prokurimit Publik në asnjë dispozitë nuk thotë se nëse i njëjti nuk përmban dispozita të veçanta duhet të zbatohen përshtatshmërisht dispozita të ndonjë ligji tjetër. Sikurse në këtë rast është krijuar një praktikë e tillë diskriminuese (diskriminim material) duke vendosur kriteret që nuk janë të përcaktuara me dispozitat materiale të LPP-së. Për më tepër AK bjen në kundërshtim me vetveten duke mos marrë parasysh kriteret, kërkesa relevante që janë drejtëpërsëdrejti të lidhura me objektin e lëndës në fjalë, parashtrohet pyetja logjike në ekstremin e kundërt çka i hyn në punë regjistrimi i mjeteve, kur ato kanë me u përdorur në një kohë të ardhme që lidhen me mirëmbajtjen dimërore ? çka është relevante dhe e lidhur drejtëpërsëdrejti me lëndën regjistrimi, ndërsa në anën tjetër kamioni ekziston, i cili do të përdoret në sezonin e dimrit ? kjo vërteton tezën se AK mundohet të gjej si shkas për eliminim arsye të paqëndrueshme, pambështetshme në aspektin juridik dhe faktik derisa propozon për dhënie të kontratës ofertën me çmimin më të lartë, në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, të LPP-së, në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit vlera për para, ekonomikiteti, efikasiteti, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë.

E dyta: Neni 69 (Aftësia teknike dhe/ose profesionale) në paragrafin 1 e përcakton shumë qartë se çka mund të kërkojë AK nga OE për të siguruar dëshmi se ata i plotësojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit. Kjo dispozitë duhet ndarë në tri pjesë të lidhura dhe të varura njëra me tjetrën, për të krijuar tërësinë e saj, ashtu siç e kërkon edhe profesionalizmi i zyrtarit përkatës që e zbaton.

Paragrafi 4 e përcakton se në procedurat që shpjen në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, AK mund të kërkojë nga OE që të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve....

Nënparagrafi 5 i par.4 që krijon tërësinë e kësaj dispozite përcakton se në këtë kuptim AK mund apo duhet të kërkojë: *raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve;*

Pra siç shihet me një interpretim të kësaj dispozite në mënyrë të thjeshtë, të logjikshme, duke mos e lexuar dhe kuptuar pjesë pjesë të ndara, por si tërësi,

pa paragjykime dhe pa imagjinimin e situatave joreale por në suaza ligjore, rezulton se kërkesa e AK-së lidhur me afatin e regjistrimit është në tërësi në kundërshtim me vet Ligjin e Prokurimit Publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sipas ligjeve tjera në fuqi, janë të përcaktuara organet publike gjegjëse të autorizuar me ligj që kanë funksion, kompetencë dhe përgjegjësi që përkujdesen për zbatimin, marrjen e masave dhe mbikqyrjen e kësaj çështje.

E treta: Përkundër se kërkesa e AK-së sa i përket regjistrimit të mjeteve nuk është kërkesë apo kriter i kërkuar sipas dispozitave të LPP-së (shih nenin 64 dhe nenin 69 par.4.5 të LPP-së) edhe vet arsyetimi i AK-së për këtë çështje është selektues dhe jo i plotë në kontekst të gjendjes faktike. Me rastin e dt. së publikimit të këtij aktiviteti që është 21.03.2019, kamionit i tipit SCANIA me tabela 06-397-DL siç dëshmohet me librezë të regjistrimit ka qenë i regjistruar deri me dt. 12.04.2019 dhe regjistrimi i skaduar tri ditë para afatit sipas njoftimit për kontratë për dorëzim të tenderit dt.15.04.2019. Për më tepër sa për njohuri të AK-së për kamion është e obliguar dy herë mbrenda vitit t'i bëhet kontrollimi i rregullsisë teknike në perioda gjashtë (6) mujore. Andaj i njejt kamion e ka të kryer periodën e dytë të rregullsisë teknike deri me dt. 06.06.2019 dhe këtë e vërtetojmë përmes Çertifikatës periodike 06 03 P00957.

Dispozita e nenit 39 (Sqarimi i Tenderëve) i RrUOPP në paragrafin 3, përcakton qartë se autoritetit kontraktues se gjatë vlerësimit të tenderëve me qëllim të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve i lejohet që të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë në aplikacion/tender. Për ta plotësuar tërësinë e kësaj dispozite me tutje përcaktohet se: "Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Pra në bazë të gjendjes faktike dhe interpretimit logjik dhe të thjeshtë të bazës ligjore sipas dispozitës së lartshënuar rezulton edhe një fakt më shumë se arsyetimi i AK-së i dhënë në pikën b) është në kundërshtim të plotë me këtë dispozitë nënligjore të RrUOPP. Siç e kemi potencuar edhe më lartë, gjendja ekzistuese faktike para publikimit për kontratë e OE ankues është në pajtim me këtë dispozitë ngase kamioni në fjalë ka pasur regjistrim para datës së publikimit për kontratë (dt. e publikimit 21.03.2019) dhe atë deri me dt. 12.04.2019, tri ditë para afatit për dorëim të tenderit sipas njoftimit për kontratë. Po ashtu ka edhe kontrollim të rregullsisë teknike deri me dt.06.06.2019 që vërteton gjendjen e rregullt teknike të mjetit për të marrë pjesë në trafik

E katërta: Përkundër se regjistrimi i mjeteve nuk është kategori që duhet të aplikohet në bazë të dispozitave të LPP-së, përkundër se kamioni në fjalë ka të kryer kontrollimin e rregullsisë teknike periodike deri me dt. 06.06.2019 dhe me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë deri tri ditë para datës së dorëzimit sipas NJK ishte i regjistruar, dhe pasqyrohet gjendja ekzistuese

para datës së publikimit të NJK në kuptim të nenit 39.3 të RrUOPP, kjo çështje në kuptim të interpretimit logjik të nenit 59 par.4 pika ii), pa paragjykim, dhe pa u keqinterpretuar për imagjinim të situatave joreale, përbën devijim të vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndryshuar kushtin material kundrejt AK-së dhe aspektin e tenderit në fjalë.

E pesta: Autoriteti Kontraktues me veprimet e saj duke mos vepruar konform dispozitave të LPP dhe duke mos iu shmangur favorizimit të OE të caktuar (në rastin konkret OE fitues) nuk është siguruar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin, lëndën e prokurimit dhe duke u siguruar që do të mere vlerën për paranë (Best value for many). Dhe si rrjedhojë duke mos iu përmbajtur procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji, e ka peshuar barabarsisht një devijim të vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndryshuar kushtin material kundrejt AK-së dhe aspektin e tenderit në fjalë me një shpenzim më të lartë të parave publike për 250,712.70€ më të shtrejtë se sa oferta e ankuesit. Se nuk është siguruar vlera për para dhe mënyra më efikasë e shfrytëzimit të fondeve publike më së miri e pasqyron shembulli konkret që do ta ilustrojmë në vijim. OE fitues në Lot 1 ka ofertuar me çmim 3,250,795.50 rreth një milion euro më lirë se sa fituesi OE Famis Co-Hc që ka ofertuar me çmim 4,276,744.89 dhe nuk është rekomanuar për kontratë, e në anën tjetër oferta e tij për lot 2 ishte 3,500,654.70€ rreth 250,712.70 më e shtrejtë se sa e ankuesit dhe është shpallur fitues.

Pra faktet dhe provat të cilat u pasqyruan në mënyrë të argumentuar dhe detajuar vërtetojnë se grupi i OE ankues ka plotësuar në tërësi kërkesat e AK-së të parashtruar në nenin 9.2 pika 5 Anexi 1 lidhur me nenin 9.1 të FTD-së, dhe në tërësi duke plotësuar kriteret/kërkesat e përzgjedhjes të dosjes së tenderit dhe kriterin e dhënies si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, mirëpo si pasojë e mos trajtimit të barabartë/diskriminimit në raport me OE fitues dhe shkeljes së qëllimit të LPP-së duke mos siguruar vlera për para në shfrytëzimin e fondeve publike, iu është cenuar e drejta ligjore për tu shpërblyer me kontratë.

Andaj nga kjo gjendje faktike e pasqyruar si më lartë duke u bazuar me fakte dhe prova materiale vërtetohet se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 lidhur me nenin 69 par.4.5 dhe nenin 72 të LPP, ngase arsyetimi i saj nuk është i qëndrueshëm për shkak se OE ankues ka plotësuar në tërësi kërkesat teknike nga pika 5 të nenit 9.1&9.2 Anexi 1 siq janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe siq kërkohen me aktin më të lartë në fushën e prokurimit, Ligjit të Prokurimit Publik 04/L-042 në nenin 69 par.4.5, dispozitë e cila nuk është zbatuar drejt.

Pretendimi Ankimor 3 lidhur me dhënien e kontratës për Lot 2 OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban“

Bazuar në dëshmitë që i kemi vërejtur gjatë qasjes zyrtare në dosjen e dorëzuar nga OE fitues, koniderojmë se i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e kualifikimit (përzgjedhjes) të

specifikuara në njoftim të kontratës dhe në dosjen e tenderit, përlatësisht kërkesat e kapacitetit teknik të kërkuara në pikën 5 të nenit 9.1&9.2 sipas listës së Anexit 1. I njëjti me të njëjta mjete ka aplikuar në të dy lotet. Dhe për më tepër për ta plotësuar kërkesat e kapacitetit teknik ka përdorur dokumente edhe për mjetet e OE "Eskavatori" përkundër se e njëjta ka marrë vet pjesë në këtë aktivitet prokurimi për dy lotet. Andaj AK është dashur që ta refuzojë si tender të papërgjegjshëm dhe mos të kalojë fare në kriterin për dhënien e kontratës sipas kriterëve të vendosura në nenin 60 të LPP-së.

Po ashtu ngrisim si pretendim qeshjen se AK me rastin e dhënies së kontratës OE në fjalë përveq se ka shkelur qenësisht nenin 59.4 dhe nenin 69 par.4.5 të LPP-së, e ka shkelur dy herë nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së ngase po të ishte i përgjegjshëm OE në fjalë oferta e tij ishte shumë më e lirë në lot 1 me çmim 3,250,000.00€ ku është shpallur fitues oferta më e shtrejtë me çmim për 4,276,744.89€ (OE Famis Co-Hc).

Pretendimi Ankimor Nr.4 - lidhur me shkeljet veç e veç dhe të ndërlidhura të dispozitave nga neni 1, neni 6, neni 7, neni 59 par.2 dhe par.4, neni 69 par.4.5 dhe neni 72 të LPP-së, lidhur me nenin 4.4, nenin 39 dhe nenin 41.3 dhe 41.7 i RrUOPP

Nga krejt ajo që u tha më lartë rrjedh se OE ankues për llot 2 ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët krahasuar me OE të shpallur fitues për 250,712.70€ më të lirë ndërsa AK me veprimet e saj të paligjshme dhe diskriminuese ia ka cenuar ankuesit të drejtën për tu shpërblyer me kontratë duke i shkaktuar dëm material, dhe në anën tjetër ka favorizuar OE fitues duke e rekomanduar për dhënie përkundër faktit se i njëjti ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm dhe që nuk plotëson kriterin e dhënies së kontratës. Andaj me këto veprime AK ka shkelur dispozitat qenësore dhe procedurale legjislaconit të prokurimit në fuqi duke filluar nga:

Neni 1 - Qëllimi dhe Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

AK duke shkelur këto dy dispozita që përbëjnë edhe parimet bazike të prokurimit publik përzgjedhë ofertën e tenderuesit të papërgjegjshëm e cila është rreth 250,712.70€ më të shtrenjtë se oferta e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë e OE Ankues "El-Bau-Conex Group".

Autoriteti Kontraktues, është i obliguar që të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin, lëndën e prokurimit dhe duke u siguruar që do të mere vlerën për paranë (Best value for many).

Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi -

Për arsye se me qëllim të favorizimit të OE tjerë të përzgjedhur me çmim më të shtrejtë për 250,712.70€, AK e eliminon OE ankues, mbi bazën e vërtetimit të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike sa i përket arsyetimit të dhënë në pikën a) dhe sa i përket

arsyetimit të dhënë në pikën b) mbi bazën e një kriteri të natyrës teknike apo dytësore që askund me asnjë dispozitë ligjore nuk përcaktohet në bazë të legjislacionit të prokurimit publik dhe që në bazë të zbatimit të nenin 59.4 të LPP-së mund të klasifikohet si devijim i vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndryshuar kushtin material kundrejt AK-së dhe aspektin e tenderit në fjalë.

Autoriteti kontraktues duhet ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial gjeografik, diskriminim material, ndërmjet operatorëve ekonomik.

Konsiderojmë se eliminimi nga pjesëmarrja e mëtutjeshme për aktivitetin e prokurimit në fjalë është bërë vetëm me shkak të trajtimit jo të barabartë/diskriminimit në raport me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Po të trajtoheshim në bazë të kriterëve të kërkuara ligjore do të ekzistonin gjasat serioze që të shpalleshim fitues për Llot -1 pasi oferta jonë ishte me çmim më të lirë për 250,712.70€ se sa oferta e OE fitues

Neni 59 par. 2 dhe 4 i LPP-së dhe neni 41.3 i RrUOPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve -

Për arsye se vlerësimi dhe krahasimi kundrejt ankuesit nuk është bërë mbi parimin e trajtimit të barabartë me OE pjesëmarrës duke mos respektuar gjendjen faktike dhe aplikimin e drejtë të dispozitave qenësore të procedurës së vlerësimit për vendosjen e drejtë dhe meritore të çështjes. Konsiderojmë se vlerësimi është udhëhequr në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parimin e ligjshmërisë (legjislacionit të aplikueshëm material për prokurimin publik – LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim), parimin e efikasitetit/efektivitetit (parimit të ruajtjes së vlerës për para). Si rrjedhojë janë dëmtuar interesat materiale të ankuesit për tu shpërblyer me kontratë nga një vendimarrje e padrejtë dhe e paligjshme e cila është e mbështetur mbi bazën e vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike dhe aplikimit të ligjit jomaterial/joprocedural për një çështje (skadimin e regjistrimit të një kamioni) që kjo sipas kuptimit të kësaj dispozite mund të konsiderohet devijim i vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndryshuar kushtin material kundrejt AK-së dhe aspektin e tenderit në fjalë, janë dëmtuar interesat materiale të ankuesit. E në anën tjetër për AK nuk ka paraqitur problem që rekomandojë për dhënie të kontratës një OE e cila është rreth 250,712.70€ më të shtrenjtë se oferta e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë e OE Ankues “El-Bau-Conex Group”.

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 dhe 60 të LPP-së. Po të trajtoheshim në mënyrë të barabartë me OE konkurent- fituesin, në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë bazë të kriterëve të kërkuara ligjore do të ekzistonin gjasat serioze që të shpalleshim fitues për Llot - 1 pasi oferta jonë ishte me çmim më të lirë.

Neni 4.4 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik. AK duke shkelur në nenin 4.4 të RRUOPP, që përbëjnë edhe parimet bazike të prokurimit publik përzgjedhë ofertën e ofertuesit e cila është rreth 250,712.70€ më të shtrenjtë se oferta e

përgjegjshme dhe me çmim më të lirë e OE Ankues "El-Bau-Conex Group". Për më tepër AK bjen në kundërshtim me vetveten duke mos marrë parasysh kritere, kërkesa relevante që janë drejtëpërsëdrejti të lidhura me objektin e lëndës në fjalë, parashtrohet pyetja logjike në ekstremin e kundërt qka i hyn në punë regjistrimi i mjeteve, kur ato kanë me u përdorur në një kohë të ardhme që lidhen me mirëmbajtjen dimërore ? çka është relevante dhe e lidhur drejtëpërsëdrejti me lëndën regjistrimi, ndërsa në anën tjetër kamioni ekziston, i cili do të përdoret në sezonin e dimrit ? kjo vërteton tezën se AK mundohet të gjej si shkas për eliminim arsye të paqëndrueshme, pambështetshme në aspektin juridik dhe faktik derisa propozon për dhënie të kontratës ofertën me çmimin më të lartë, në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59 të LPP-së, në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit vlera për para, ekonomiciteti, efikasiteti, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë.

Neni 60 - Kriteret për dhënien e kontratës -

Për arsye se grupi i OE ankues përkundër iu është mohuar dhënia e kontratës si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët karrshi OE të rekomanduar për kontratë (250,712.70€ më e lirë se oferta e fituesit) në bazë të gjendjes faktike dhe nga një rivlerësim i drejtë dhe i ligjshëm rezulton se ankuesi ka dorëzuar tender të përgjegjshëm në përputhshmëri me kërkesat formale të nga aspekti administrativ dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e kualifikimit (kriteret e përzgjedhjes) të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit si dhe tenderin që plotëson kriterin e dhënies së kontratës. Në anën tjetër konsiderojmë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuki ka përmbushur kërkesat e minimale të kualifikimit që hyn tek kërkesat e përzgjedhjes të cilat nga AK janë specifikuar në njoftimin për kontratë dhe dosjes së tenderit në kuptim të nenit 56 paragrafi 1.1. të LPP-së, andaj i njëjti nuk është dashur mos të kalojë fare në vlerësimin e kriterit për dhënien e kontratës sipas kritereve të vendosura në nenin 60 paragrafi 1.1. të LPP-së, që është kusht i detyrueshëm ligjor.

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Për aktivitetin në fjalë nga grupi i operatorëve ekonomik "Magjistralla&Alb Building" është ofruar çmimi dukshëm më i ulët në krahasim me dy operatorët tjerë ekonomik pjesëmarrës për pjesën - Regionin e Gjilanit.

Neni 64 pika iii) i LPP-së- Dëshmitë e Kërkesave

AK me rastin e vensosjes së kërkesës në pikën 5 të nenit 9.2 lidhur me nenin 9.1 të FTD-së lidhur me kërkesën për regjistrimin e mjeteve nuk ka vepruar në harmoni me nenin 64 pika iii) për faktin se ky nen shumë qartë e shtjellon se një kandidat/tenderues duhet t'i plotësojë kriteret e kërkuara nga AK sipas neneit 69-71 të këtij ligji, ku shprehimisht thuhet: *OE duhet t'i plotësojnë kriteret e kërkuara nga AK sipas nenit 68 - 71*. Pra në kuptim të dispozitave të neneve 68-71 specifikisht nenit 69 të LPP-së regjistrimi i mjeteve nuk është kategori që aplikohet në bazë të LPP-së. Ligji i Prokurimit Publik në asnjë dispozitë nuk thotë se nëse i njëjti nuk përmban dispozita të veçanta duhet të zbatohen përshtatshëmrisht dispozita të ndonjë ligji tjetër.

Neni 69 par.4.5 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale

Për arsye se kundrejt grupit të grupit të OE ankues "El-Bau&Conex Group", AK në arsyetimin e dhënë për eliminim sipas pikës a) sa i përket kërkesës në pikën 5 nenin 9.1&9.2 të FTD-së ka nxjerrë vlerësim të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike duke mos zbatuar drejt dispozitën e nenit 69 par.4.5 lidhur me nenin 64 të LPP-së për arsyet, faktet dhe provat e paraqitura si më lartë.

Neni 72 i LPP-së dhe neni 39 dhe 41.7 i RrUOPP- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Për arsye se AK kundrejt grupit të grupit të OE ankues "El-Bau&Conex Group", fare nuk e ka zbatuar këtë dispozitë të së drejtës materiale që në rastin konkret ka pasur detyrim ta zbatojë për të kërkuar nga OE ankues informacione shtesë për të sqaruar këtë aspekt të tenderit lidhur me çështjen që e ka përdorur për eliminim me arsyetimin e dhënë në pikën a) por edhe në pikën b) të Letrës Standarde edhe pse kjo çështje është tejet e qartë si në aspektin faktik e po ashtu edhe në kontekst ligjor ngase të gjitha dëshmitë dokumentare për ta plotësuar kërkesën nga neni 9.1&9.2 pika 5 janë pjesë e dosjes së tenderit siç edhe e vërtetuar më lartë nga përshkrimi që ë bëmë duke ju referuar dëshmimeve dokumetare që janë pjesë e dosjes së tenderit.

Pretendimi Ankimor 5 lidhur me shkeljen e Neni 108/A paragrafi 12 - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve i LPP-së – Neni 8.2 i Rregullave për paraqitje të kërkesave për rishqyrtim pranë AK-së

Me këtë vendim AK nuk ka eliminuar asnjërin nga shkeljet e cekura në pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në kërkesën për rishqyrtim. AK nuk ka shqyrtuar asnjërin nga pretendimet ankimore dhe nuk ka analizuar, shqyrtuar dhe administruar faktet dhe provat materiale të cilat janë pasqyruar në ankesë. Asnjërin prej tyre nuk e ka vlerësuar në pajtim me dispozitën qenësore të vlerësimit, nenin 59.4 të LPP-së lidhur me nenin 1, nenin 6, nenin 7, nenin 69 par.4.5 dhe nenin 72 të LPP-së e që për pasojë ka ngjellur pranë rezultatit të njëjtë i cili nuk është i bazuar dhe nxjerr mbi vlerësime të drejta dhe të ligjshme. Ky vendim është në kundërshtim edhe me Ligjin e Përgjithshëm të Procedurës Administrative të nenit 48 (arsyetimi i një akti administrativ) pasi që nuk përmban elementet e arsyetimit që duhet ti ketë një akt administrativ në rastin konkret vendim siç kërkohet edhe me legjislacionin e LPP-së, ngase në vendim nuk është dhënë asnjë arsyetim që: shpjegon situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkakët të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, shkakët për të cilat nuk janë pranuar pretendimet ankimore, shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Nga përmbajtja e vendimit vërehet se AK nuk i ka vlerësuar asnjërin nga pretendimet ankimore. Për të gjitha pretendimet ankimore është përgjigjur duke përshkruar arsyetimin e njëjtë sikurse në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar - OE ankues.

-----perfundim i pretendimeve ankimore-----

Kështu që me të gjitha këto veprime në raport me OE në fjalë të bazuara në faktet dhe provat e lartëcekura konsiderojmë se AK ka shkelur dispozitat qenësore dhe procedurale legjislacionit të prokurimit në fuqi duke filluar nga: neni 1, neni 6, neni 7 par.1,2,4, neni

56 par.1.1 dhe 1.2, neni 59. 4, neni 60 par.1.1, nenin 69 të LPP-së nenin nenit 4.4, nenit 39, nenit 41.3 dhe 41.7 për Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Andaj kërkohet që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe provave të paraqitura, Organi Shqyrtues i Prokurimit të merr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si e bazuar ANKESA e Grupi i OE "EL-BAU" sh.p.k. & CONEX GROUP" sh.p.k.;
- II. **ANULOHET** Vendimi i AK-së i Nr.prot. 5482 i dt. 22.05.2019 me të cilin është Refuzuar si e pabazë Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar në emër të grupit të konzorciumit nga OE ankues "El-Bau Sh.p.k" si dhe në anën tjetër është vërtetuar dhe lënë në fuqi vendimi i atakuar për dhënien e kontratës OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban" për Lot 2 , i dt. 14.05.2019;
- III. **ANULOHET** Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban" për Lot 2 , i dt. 14.05.2019;
- IV. **ANULOHET** Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, grupin e OE "El-Bau Sh.p.k.&Conex Group Sh.p.k.", i dt. 14.05.2019, me propozim që kjo lëndë të kthehet në RI-VLERËSIM duke marrë masa korrigjuese nga AK për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj

8. Dëmet materiale

Përshikruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Grupi i Operatorëve Ekonomik "EL-BAU" sh.p.k. & CONEX GROUP sh.p.k. në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore të lejuara, dhe Kërkesës për kompensimin e dëmeve, duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten ne kopje dokumentet, faktet, provat e konstatuara me larte.